

VENDIM
Nr. 62, datë 26.2.2026

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SHPK PËR
HEQJEN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “dh”, 7, paragrafët 2 dhe 9, germa “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 5.1, germa “dh”, të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 468/1 prot., datë 26.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfini Consulting’ sh.p.k. për heqjen e licencave në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfini Consulting” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 558, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 6.6.2023, për një afat 5-vjeçar (deri më 6.6.2028).

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 468 prot., datë 3.2.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për revokimin e kësaj licence, për arsye se nuk e ka ushtruar veprimtarinë e licencuar.

- Në nenin 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenin 5, germa “dh”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.4.2017; të pikës 5.1, germa “dh”, të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, përcaktohet se: “ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.”.

- Në nenin 7, paragrafi 2 i rregullores së sipërcituar përcaktohet se: “Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e”, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, germa “d”, të kësaj rregulloreje parashikohet se ...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe/ose “e”, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.

- Rezulton se shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për këto arsye dhe në rrethanat kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, vlerësohet të vijohet me miratimin e saj dhe heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e shoqërisë “Proinfini Consulting” sh.p.k. e humbet fuqinë juridike dhe hiqet dhe nga regjistri i licencave.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., për heqjen e licencës nr. 558, seria T23, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr.188, datë 6.6.2023, për një afat 5-vjeçar.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti